



Deçan, dt.28.07.2015

Në bazë të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujtëshme të Komunës, Ligji nr.04/L-144, në zbatim të Rregullores Komunale për Procedurat e Dhënies së Objekteve të Komunës dhe Tokës për Shfrytëzim Afatshkurtër Përmes Ankandëve nr.01-1974, dt.03.04.2013, si dhe Vendimit për Dhënien me Qera në Shfrytëzim Afatshkurtër të Fabrikës për Përpunimin e Mjaltit “GOLDEN HONEY-DEÇAN” 01Nr.IX-6 të dt.30.12.2014, me nr. Të protokollit 01-512, Komisioni Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së palujtëshme të Komunës bën këtë:

SHPALLJE

Për dhënien në shfrytëzim afat shkurtër deri në pesëmbëdhjet (15) vite me qera të Fabrikës për Përpunimin e Mjaltit “GOLDEN HONEY-DEÇAN” pronë e Komunës së Deçanit me konkurs publik

Ftohen të gjithë të interesuarit që t'i dorëzojnë ofertat e tyre për marrjen në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 vite, me qera të Fabrikës për Përpunimin e Mjaltit “GOLDEN HONEY-DEÇAN” pronë e Komunës së Deçanit e evidentuar në tabelën vijuese:

Komuna	Zona Kadastrale	Certifikata e pronësisë Nr.UL	Lloji I Kulturës	Sipërfaqja në Hektar	Çmimi fillestar €/ në muaj ne sipërfaqe te objektit 600 m ²
Deçan	Deçan	70505021-00342-0	Mal I Klasit të 3	01.27.92	1 € per m ² te objektit

Çmimi fillestar I ofruar në muaj ne sipërfaqe te objektit 600 m² nenkupton parcelen komplet pra objekti, parkingu dhe hapsirat e parkut te bleteve.

Kriteret për të qenë pjesëmarrës në Konkurs janë:

- Kopja e dokumenteve identifikuese (për personat fizik)
- Çertifikata për regjistrimin e biznesit (për personat Juridik)
- Çertifikata për kryerjen e obligimeve tatimore nga ATK-ja , jo më e vjetër se tre muaj nga dita e aplikimit;
- Depoziten e minimumit te qerese mujore, pra vlere 600 euro e depozituar ne njeren nga bankat e Kosoves (flet depozita merret ne zyren e prokurimit)
- Plani i biznesit për shfrytëzim të objektit dhe ngastres si dhe burimet e financimit (disponueshmëria financiare për aktivitetin);
- Deklarata e nenshkuar e ofertuesit qe I bashkangjitet planit te biznesit per minimum te numrit te punetoreve jo me pak se 10 te punesuar

- Veprimtari kryesore e aktivitetit ekonomik eshte bletaria ndërsa veprimtari dytesore aktivitetet tjera te industise ushqimore por jo veprimtari prodhuese siq jane industria metalike dhe ajo e perpunimit te drurit..
- Garancion banker I ofertes vlere minimale 7200.00 euro me validitet 120 dite,
- Qarkullimi bankar I ofertuesit tri vitet e fundit (kopjet e karteleve bankare)
- Ofertuesit duhet te konkurojne me oferten e tyre ne zarf te mbyllur dhe me dosjen e konkursit ne nje kopje origjinali I dokumentave dhe kopja e dyte kopjet e dokumenteve per ofertim

Kriteret e vlerësimit të ofertave:

- Çmimi më I favorshëm ekonomik- 40% e vlerësimit;
- Plani më I suksesshëm afarist (plani i biznesit) dhe disponueshmëria financiare- 30% e vlerësimit;
- Numri I punëtorëve që do të inkuadrohen në biznes 30% e vlerësimit.

Afati I fundit I dorëzimit të ofertave:

- Afati I fundit I dorëzimit të ofertave është tridhjetë (30) ditë nga dita e publikimit të konkursit, deri me 02.09.2015 (e merkure), në ora 10:00;

Fletëparaqitjet për pjesëmarrje në ofertim mund të merren dhe dorëzohen në këtë adresë:Komuna e Deçanit, 51000, Sheshi “Mentor Tolaj” pn.Deçan, apo drejtpërdrejt në Zyrën e Prokurimit-Objekti i Administratës Zyra nr.25.

Hapja e ofertave:

- Hapja e ofertave do të bëhet me dt.02.09.2015, në ora 10:30, në Sallën e Konferencave në Objektin e Komunës në Deçan;

Shënim per procedura:

- Konkursi public mund te filloi me me se paku nje pjesmarres ne konkurs publick me oferte ne zarf te mbyllur
- Dokumentacionet që nuk I plotësojnë kriteret e konkurimit nuk do të merren në konsiderim nga Komisioni.

-Pjesëmarrësit e pakënaqur në Konkursin Publik mund të dorëzojnë kundërshtim te Komisioni për Ankesa, në afat prej tri ditësh nga dita e mbajtjes së konkursit publik. Pas kundërshtimit me aktvendim Komisioni është I detyruar që të vendosë në afat prej pesë (5) ditësh nga dita e pranimi të të njëjtit.

Komisioni Vlerësues:

Kjo shpallje do të publikohet:

- Ueb faqen zyrtare të Komunës së Deçanit: kk.rks-gov.net/deçan;
- Tabelën e shpalljeve publike të Komunës.

Deçan,dt.28.07.2015

Kryesuesi I Komisionit:
Agron Demukaj
